

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXV, nr. 7966
E enjte, 9 janar 2025
Çmimi 0.50

Limaj: Koalicioni AAK-Nisma përfaqëson të gjitha shtresat e shoqërisë | **FAQE 5**




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



KQZ-ja MIRATON FLETËVOTIMIN PËR ZGJEDHJET E 9 SHKURTIT, PËRFSHIHET EDHE LISTA SERBE

FAQE 4-5

AKTUALE



KRASNIQI: TALLJA E RADHËS E BASHKIMIT EUROPIAN ME QEVERINË KURTI F. 7

PDK-ja ME MBI 1,700 TUBIME ANEMBANË KOSOVËS F. 6

KOSOVA NIS IMUNIZIMIN E DJEMVE KUNDËR PAPILOMA VIRUSIT F. 3

MORËN PJESË NË AKTIVITETE PARTIAKE, SUSPENDOHEN TRE ZYRTARË POLICORË F. 7

EKONOMI



NAFTËTARËT DHE NDËRTIMTARIA NËN LLUPËN E MINT-it F. 8

ULET ÇMIMI I ENERGISJË PËR KONSUMATORËT FAMILJARË NË SHQIPËRI F. 8

SPORT



NIPI I ADEM JASHARIT, IGBALL JASHARI PËRFORCON DRENICËN F. 10

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka miratuar dizajnin dhe përmbajtjen e fletëvotimit për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të cilat do të mbahen më 9 shkurt 2025. Gjithashtu, KQZ-ja miratoi edhe broshurën me listën e emrave të të gjitha subjekteve politike dhe kandidatëve të certifikuar për pjesëmarrje në zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës. Ndërkaq dy ditë më parë subjektet politike në Kosovë janë pajisur me numra me të cilët do të garojnë në zgjedhjet e rregullta parlamentare të 9 shkurtit

ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS 2025 IZBORI ZA SKUPŠTINU REPUBLIKE KOSOVA 2025	
1	Shënjoni VETËM NJË subjekt politik. Oznaçite SAMO JEDAN politički subjekat
2	Shënjoni DERI në DHJETË kandidat. Oznaçite DO DESET kandidata
111	IRDK INICIATIVA E RE DEMOKRATIKE E KOSOVËS - IRDK
112	SRPSKA LISTA
113	Jedinstvena Goranska Partija
114	PARTIA ROME E BASHKUAR E KOSOVËS
115	PARTIA LIBERALE EGJIPTIANE-PLE
116	SRPSKA DEMOKRATIJA
117	Partia Balli Kombëtar Demokrat Shqiptar
118	Lëvizja VETËVENDOSJE!
119	NOVA DEMOKRATSKA STRANKA
120	Partija kosovskih Srba
121	Naša Bošnjačka Koalicija (Naša Inicijativa i Bošnjačka stranka)
122	Kosova Adalet Türk Partisi
123	PAJ PARTIA E ASHKALINJËVE PËR INTEGRIM
124	LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS - LDK
125	PDAK-LPB
126	GRADJANSKA INICIJATIVA NARODNA PRAVDA
127	SDU SOCIJALDEMOKRATSKA UNIJA - SDU
128	Fatmir Bytyqi
129	Koalicioni për Familje
130	Yenilikçi Türk Hareket Partisi
131	PDK PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS - PDK
132	Za Slobodu Pravdu i Opstanak
133	Srpski narodni pokret
134	KOSOVA DEMOKRATIK TÜRK PARTISI
135	Koalicija Vakut
136	Opre Roma Kosova
137	AAK - ALEANCA PËR ARDHMËRINË E KOSOVËS NISMA - Nisma Socialdemokrate, Konservatorët, Intelektualët
138	FJALA



EDHE NGA DY MUAJ PARABURGIM NDAJ TË DYSHUARVE PËR SULMIN TERRORIST NË IBËR-LEPENC F. 3

KOSOVA MBYLL EDHE DY INSTITUCIONE SERBE NË VERI F. 7



RENOVA
Maqedoni PUTZ
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
E-mail: renova@mt.net.mk
Mobi: +377 44 501289

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

Donald Trump: Duam Groenlandën dhe Kanalin e Panamasë. Nuk e përjashtoj përdorimin e ushtrisë

Donald Trump, i cili pritet të rikthehet në Shtëpinë e Bardhë, ka refuzuar të përjashtojë përdorimin e forcës ushtarake amerikane për të rimarrë kontrollin e Kanalit të Panamasë dhe për të blerë Groenlandën, duke përmendur si justifikim sigurinë ekonomike. Deklaratat e tij gjatë një konference për shtyp në Mar-a-Lago kanë ngritur shqetësime ndërkombëtare për një ndryshim të mundshëm në politikën amerikane. Gjatë një takimi me gazetarët në rezidencën e tij në Florida, Trump tha se nuk mund të jepte garanci se nuk do të përdorte forcë ushtarake ose presion ekonomik për këto çështje. “Nuk mund t’ju jap siguri për asnjërën prej këtyre,” tha ai në përgjigje të një pyetjeje nga një reporter. “Por mund të them këtë: na duhen për sigurinë ekonomike.”

Kërkesa për Kanalin e Panamasë

Trump pretendoi se Kanali i Panamasë, i cili iu transferua

Panamasë në vitin 1999 sipas një traktati të vitit 1977, po “menaxhohet nga Kina”. Ai shtoi se kanali është kritik për interesat amerikane. “Kanali i Panamasë u ndërtua për ushtrinë tonë,” tha Trump. “Shikoni, Kanali i Panamasë është jetik për vendin tonë. Po menaxhohet nga Kina. Kina! Dhe ne ia dhamë Kanalin e Panamasë Panamasë, jo Kinës.”

Objektivi Groenlandë

Sa i përket Groenlandës, Trump kërcënoi me masa ekonomike ndaj Danimarkës, duke theksuar se, nëse kjo e fundit kundërshton ambiciet e tij territoriale, “do t’i vendosim Danimarkës tarifa shumë të larta”. Ai gjithashtu kritikoi Kanadanë, duke thënë se vendi mbështetet te ushtria amerikane dhe paralajmëroi për tarifa të rënda ekonomike ndaj saj.

“Kanada subvencionohet me rreth 200 miliardë dollarë në vit dhe, praktikisht, nuk ka një ushtri. Ata mbështeten te ushtria jonë,” tha Trump.

Fushata e djalit të Trump në Groenlandë

Në ndërkohë, Donald Trump Jr., i cili ndodhej në kryeqytetin e Groenlandës, Nuuk, shpërndau kapele me sloganin “Make Groenland Great Again” duke pretenduar se ishte atje thjesht si turist. Në një video, Trump Sr. dëgjohet duke thënë gjatë një telefonate: “Do t’ju trajtoj më mirë.”

Tensionet me Panamanë dhe Danimarkën

Qasja e Trump ndaj Kanalit të Panamasë dhe Groenlandës ka shkaktuar reagime të forta. Presidenti i Panamasë, José Raúl Mulino, refuzoi kërkesat e Trump për kthimin e kanalit, duke deklaruar se “çdo metër katror” i tij do të mbetet nën sovranitetin panamez. Këto deklarata vijnë pasi Trump kërcënoi që SHBA do të “kërkojë që Kanali i Panamasë të kthehet nën Shtetet e Bashkuara – plotësisht, shpejt dhe pa asnjë



pyetje”. Këto qëndrime janë parë si një përshkallëzim i tensioneve mbi këtë pasazh të rëndësishëm detar, që SHBA fillimisht e ndërtoi në vitin 1914 dhe e

menaxhoi për pjesën më të madhe të shekullit të 20-të. Qasja e tij konfrontuese risjell jehonën e tensioneve që çuan në pushtimin e Panamasë nga SHBA në vitin 1989. / *bota.al*

Ukraina sulmon një depo nafte që përdorej nga forcat ajrore ruse

KIEV, 8 JANAR - Ukraina ka theksuar se forcat e saj kanë goditur një depo ruse të naftës që i shërbente forcave ajrore të Moskës e që gjendej qindra kilometra larg nga kufiri që ndan dy shtetet.

Ky sulm është në serinë e sulmeve përshkallëzuese ndërkufitare që kanë kryer Moskë dhe Kievi dhe që kanë pasur për shënjestër infrastrukturën energjetike dhe ushtarake, pothuajse tre vjet pasi Kremli nisi pushtimin e paprovokuar të Ukrainës.

“Forcat ukrainase të mbrojtjes goditën një depo ruse të naftës në Engels në rajonin e Saratovit”, ka njoftuar shtabi i përgjithshëm i ushtrisë ukrainase përmes një



njoftimi të publikuar në rrjetet sociale. “Duhet të theksojmë se kjo depo nafte furnizonte me karburante bazën ajrore

ushtarake, Engels-2, ku gjendet aviacioni strategjik i armikut”, është thënë në njoftim. Në deklaratat e mëhershme, zyrtarët

rusë pranuan se Ukraina kishte sulmuar rajonin me dronë.

Ministria ruse e Mbrojtjes ka thënë se sistemet e mbrojtjes ajrore kanë rrëzuar 32 dronë ukrainas gjatë natës, përfshirë 11 mbi rajonin e Saratovit. Guvernatori i rajonit, Roman Busargin, ka thënë se ekipet e emergjencave janë dislokuar në një ndërtesë industriale që është përfshirë nga flakët pas një sulmi ukrainas me dron. Por, ai nuk dha detaje se për çfarë ndërtesë bëhej fjalë.

Busargin ka shtuar se nuk ka të lënduar nga sulmet. Kievi ka marrë përgjegjësinë edhe për sulme të mëhershme që kanë pasur për shënjestër depo të

naftës, teksa Ukraina po vazhdon përpjekjet e saj për të ndërprerë të ardhurat ruse nga energjia, që thotë se i përdor për të financuar luftën e saj kundër Ukrainës. “Shkatërrimi i depon së naftës krijon probleme të mëdha logjistike për aviacionin strategjik rus dhe ul ndjeshëm aftësitë e tij për të sulmuar qytetet paqësore ukrainase dhe objektet civile”, ka thënë ushtria ukrainase.

Po ashtu, Kievi ka treguar se gjatë natës së mërkurë, mbrojtja ajrore ukrainase ka rrëzuar 41 dronë rusë, ndërkaq 22 të tjerë janë rrëzuar apo janë zhdukur nga radarët pas ndërhyrjes në sistemet e tyre elektronike.

Përmblytje masive në Arabinë Saudite

RIAD, 8 JANAR - Arabia Saudite po përjeton shira të rrëmbyeshëm të paprecedentë dhe përmblytje të rënda që përfshijnë rrugët dhe lagjet në disa qytete në mbarë mbretërinë.

Qendra Kombëtare për Meteorologji ka lëshuar alarme paralajmëruese me nivele të ndryshme në të gjithë mbretërinë, duke përfshirë alarmin e lartë të kuq në qytetet e shenjta Mekë dhe Medine në

Arabinë Perëndimore, si dhe në zonat e rajonit lindor. Kryeqyteti Riad në Arabinë Saudite qendrore dhe provincat jugperëndimore Aseer dhe Jazan gjithashtu janë alarmuar nga një nivel më i ulët portokalli i ashpërsisë, por gjithsesi njerëzve iu kërkua të qëndrojnë vigilentë mes reshjeve të parashikuara.

Autoritetet e shpëtimit të mbretërisë, duke përfshirë

Autoritetin e Gjysmëhënës së Kuqe, kanë rritur gatishmërinë e tyre në përgjigje të paralajmërimeve të shirave të dendur.

Sipas Agjencisë Saudite të Shtypit, Gjysmëhëna e Kuqe, ka konfirmuar gatishmërinë e plotë operacionale për ekipet e saj të shpëtimit për të siguruar shërbim të pandërprerë të ambulancës dhe ndërhyrje të shpejta.

Autoritetet saudite gjithashtu kanë paralajmëruar qytetarët që të qëndrojnë të kujdesshëm dhe të ndjekin udhëzimet e sigurisë, veçanërisht në zonat që u paralajmëruan nga alarmet e nivelit të lartë.

Shërbimi i Mbrojtjes Civile u ka bërë thirrje njerëzve të qëndrojnë larg luginave, zonave fushore dhe zonave ku mund të grumbullohen ujërat e reshjeve. Videot në llogaritë e mediave



sociale kanë dokumentuar shtrirjen e përmblytjeve me rritjen e nivelit të ujit, përmblytjet e makinave në rrugë, si dhe me ndërtesat në ujë për shkak të reshjeve të mëdha dhe stuhive.

Kosova nis imunizimin e djemve kundër papilloma virusit

PRISHTINË, 8 JANAR - Nga shkurti, në Kosovë do të nisë imunizimi i djemve me vaksinën kundër papilloma virusit (HPV), pasi një vaksinë e tillë nisi të administrohej për vajzat vitin e kaluar.

Në një konferencë për media, të organizuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike, u tha se që nga nisja e procesit të imunizimit, 10.000 vajza janë vaksinuar kundër këtij virusi.

Çfarë është papilloma virusi (HPV)?

Papilloma virusi (HPV) është një infektim që transmetohet seksualisht. Pothuajse të gjithë personat që janë seksualisht aktivë, në një moment të caktuar të jetës infektohen me këtë virus, por në shumicën e rasteve nuk shfaqin simptoma. Në grupin e HPV-së hyjnë më shumë se 200 lloje të viruseve. Në shumicën e rasteve, ky virus nuk shkakton shqetësim, por infektimi me disa lloje të tij mund të shkaktojë probleme serioze shëndetësore dhe kancer.

HPV-ja mund të prek lëkurën, zonën gjenitale dhe fytin.

Prezervativët mund të ndihmojnë në mbrojtjen kundër infektimit me HPV, por nuk ofrojnë mbrojtje të plotë. Më 2019, HPV-ja vlerësohet se ka shkaktuar 620.000 raste të kancerit të gratë dhe 70.000 raste të kancerit të burrat, sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë. Rastet e kancerit me HPV mund të parandalohen përmes vaksinimit të hershëm.

Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, tha se nisja e imunizimit të djemve me vaksinën HPV është hap thelbësor drejt parandalimit të sëmundjeve serioze. "HPV është virus i rrezikshëm. Kanceret që mund të shkaktohen nga ky virus nuk bëjnë dallime dhe vaksinimi i djemve është një hap jashtëzakonisht i rëndësishëm për të mbrojtur edhe ata nga



pasojat shëndetësore në të ardhmen", tha Vitia.

Sipas tij, HPV shkakton probleme shëndetësore edhe te djemtë edhe te vajzat si dhe lloje të ndryshme të kancereve. Kosova vitin e kaluar futi në kalendarin e imunizimit vaksinën HPV. Vajzat e vaksinuara janë të moshës 11-12 vjeç. E njëjta grup-moshë e djemve synohet të imunizohet, thanë nga MSH-ja dhe IKSHPK-ja, përfaqësuesit e të cilëve u bënë thirrje prindërve që të imunizojnë fëmijët e tyre. Autoritetet bënë të ditur se veçse janë shpërndarë në nivel vendi, dozat e kësaj vaccine do të jepen falas.

Paralelisht me nisjen e imunizimit të djemve, do të vazhdojë edhe vaksinimi i vajzave.

Më 2022, Kosova kishte siguruar dozat e para të vaksinës, marrja e së cilës është e rekomandueshme, por jo e detyrueshme.

Që nga nisja e dhënies së kësaj vaccine, Fetije Fetaj, nga IKSHPK tha se nuk është raportuar për asnjë rast që ka pasur efekte të rënda anësore.

Rekomandimet për vaksinat HPV

Sipas një studimi të bërë më parë nga organizata "Cancer Research", me seli në Britani, vakcina HPV zvogëlon rastet e kancerit të qafës së mitrës për gati 90 për qind. Organizata Botërore e Shëndetësisë thotë se vaksinat HPV funksionojnë më mirë nëse ato

administrohen para ekspozimit ndaj papilloma virusit.

Klinika Mayo në Shtetet e Bashkuara thotë se vakcina HPV i jep trupit një mënyrë të sigurt për të ndërgjegjësuar sistemin imunitar për HPV-në. Kjo nënkupton se trupi e ka më të lehtë që të pastrojë gjurmët e virusit, nëse një person infektohet më vonë me të.

Ndërkaq, OBSH-ja rekomandon që vajzave nga moshë 9 deri në 14 vjeç të vaksinohen me një apo dy doza. Rekomandimi njëjtë vlen edhe për vajzat dhe gratë të moshës 15 deri në 26 vjeç.

OBSH, ndërkaq, rekomandon dy doza, në një interval prej gjashtë muajsh, për gratë më të vjetra se 21 vjeç. "Një minimum prej dy dozash dhe

kur është e mundshme edhe prej 3 dozash mbeten të nevojshme për ata persona që dihet se e kanë të kompromentuar sistemin imunitar apo janë të infektuar me HIV", thuhet në rekomandimet e organizatës.

OBSH po ashtu thotë se përveç vaksinimit të vajzave 9-14 vjeç, para se të nisnin të jenë seksualisht aktive, rekomandohet që të vaksinohen edhe djemtë, kur është e mundur.

Qendrat amerikane për Kontrollin dhe Parandalimin e sëmundjeve (CDC) thonë se vakcina HPV nuk rekomandohet për personat mbi 26 vjeç.

Por, vaksinimi i personave mbi 26 vjeç e deri në 45 vjeç mund të bëhet vetëm me rekomandimin e mjekut. "Vakcina HPV sjell pak përfitime në këtë grup-moshë, për disa arsye, përfshirë edhe atë se më shumë njerëz të këtij grupi veçse mund të jenë ekspozuar ndaj HPV-së", thuhet në ueb-faqen e CDC-së.

Vakcina HPV në kalendarin e vaksinimit të disa vendeve të rajonit

Në disa vende të Ballkanit Perëndimor, vakcina HPV është në kalendarin e detyrueshëm të vaksinimit. E fundit që futi në kalendar këtë vaksinë ishte Shqipëria, në nëntor të vitit 2022.

Në shtator të po atij viti, Mali i Zi kishte nisur administrimin e kësaj vaccine.

Maqedonia e Veriut e ka këtë vaksinë në kalendar që nga viti 2013 dhe vakcina është e detyrueshme për grup-moshën 12 deri në 26 vjeç dhe jepet në tri doza.

Në kalendarin e vaksinimit të Serbisë është po ashtu HPV. Në këtë shtet, kjo vaksinë rekomandohet të merret, por nuk është e obligueshme.

Vakcina HPV jepet edhe në Bosnje e Hercegovinë, ndonëse nuk është e obligueshme.

Edhe nga dy muaj paraburgim ndaj të dyshuarve për sulmin terrorist në Ibër-Lepenc

PRISHTINË, 8 JANAR - Gjykata Themelore në Prishtinë ua ka vazhduar masën e paraburgimit edhe për nga dy muaj, Dragisha dhe Jovan Viqentijeviq, të dyshuar për sulmin e 29 nëntorit 2024 në kanal in e Ibër-Lepencit në Varagë të Zubin-Potokut.

Këtë e ka konfirmuar për "Betimi për Drejtësi", Mirlinda Gashi, zëdhënëse e Gjykatës Themelore në Prishtinë. "Ju njoftojmë se pas kërkesës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës të datës 23.12.2014 për vazhdimin e masës së

paraburgimit në çështjen penale kundër të pandehurve J.V. dhe D.V., Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti Special me datë 27.12.2024 ka marrë aktvendim dhe ka aprovuar kërkesën e PSRK-së, ashtu që masa e paraburgimit të pandehurve J.V. dhe D.V., iu vazhdohet në kohëzgjatje prej 2 (dy) muaj, për secilin", ka bërë me dije Gashi.

Sipas sosjes së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, Jovan Viqentijeviq dyshohet se bashkë me vëllain e tij, Dragisha Viqentijeviq me

qëllim kanë dëmtuar pajisjen e ujësjellësit dhe kanë kryer veprën terroriste, duke përdorur eksploziv.

Shpërthimin në kanal in e ujit të Ibër-Lepencit në fshatin Varagë të Zubin-Potokut, i cili dyshohet se u bë me rreth 20 kilogramë eksploziv, autoritetet e Kosovës e kanë cilësuar si sulm terrorist dhe se përgjegjëse thanë se është Serbia. Sulmin e kanë dënur ashpër edhe ndërkombëtarët. Lidhur me këtë rast gjatë kontrolleve në veri, Policia ka sekuestruar armë, municion, e pajisje tjera.



KQZ-ja miraton fletëvotimin për zgjedhjet e 9 shkurtit, përfshihet edhe Lista Serbe

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka miratuar dizajnin dhe përmbajtjen e fletëvotimit për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të cilat do të mbahen më 9 shkurt 2025. Gjithashtu, KQZ-ja miratoi edhe broshurën me listën e emrave të të gjitha subjekteve politike dhe kandidatëve të certifikuar për pjesëmarrje në zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës. Ndërkaq dy ditë më parë subjektet politike në Kosovë janë pajisur me numra me të cilët do të garojnë në zgjedhjet e rregullta parlamentare të 9 shkurtit

EPOKA E RE

MAL QORRAJ

PRISHTINE, 8 JANAR - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka mbajtur të mërkurën mbledhjen e dytë në këtë vit të kryesuar nga kryesuesi, Kreshnik Radoniqi.

Në këtë mbledhje KQZ-ja miratoi dizajnin dhe përmbajtjen e fletëvotimit për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të cilat do të mbahen më 9 shkurt 2025. Në këtë fletëvotim është përfshirë edhe Lista Serbe.

Gjithashtu, KQZ-ja miratoi edhe broshurën me listën e emrave të të gjitha subjekteve politike dhe kandidatëve të certifikuar për pjesëmarrje në zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Ndërkaq dy ditë më parë subjektet politike në Kosovë janë pajisur me numra me të cilët do të garojnë në zgjedhjet e rregullta parlamentare të 9 shkurtit, pasi Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka organizuar hedhjen e shortit për renditjen në fletëvotime. Numrat e subjekteve politike në fletëvotime janë nga 111 deri në 138.

Sipas këtij shorti, Lëvizja Vetëvendosje do të garojë me numrin 118, PDK-ja me numrin 131, LDK-ja me numrin 124 dhe Koalicioni AAK-Nisma me numrin 137.

Për këto zgjedhje janë certifikuar 28 subjekte politike me 1 280 kandidatë.

Në fletëvotim qytetarët do të mund të zgjedhin një subjekt politik dhe deri në dhjetë kandidatë për deputetë. Ky është një ndryshim pas miratimit të Ligjit të ri për Zgjedhjet. Në të kaluarën qytetarët kanë pasur mundësinë të zgjedhin deri në pesë kandidatë.

Secila parti e certifikuar mund të ketë deri në 110 kandidatë në listën zgjedhore. Nga këto lista do të zgjidhet përbërja e re e Kuvendit me 120 ulëse dhe deputetët më pas zgjedhin qeverinë e re. Qeveria aktuale në Kosovë udhëhiqet nga Albin Kurti, kreu i Lëvizjes Vetëvendosje.

Këto janë përgatitjet e fundit të

KQZ-së për zgjedhjet, teksa fushata zgjedhore do të nisë të shtunën, më 11 janar, dhe për një muaj partitë dhe kandidatët do të tentojnë t'i bindin votuesit të votojnë për ta.

Për dallim nga zgjedhjet e kaluara, kur heshtja zgjedhore fillonte një ditë para votimeve, me ndryshimet ligjore të këtij viti ajo tashmë do të fillojë një minutë para hapjes së qendrave të votimit, në orën 07:00 dhe do të zgjasë deri në mbylljen e tyre, në orën 19:00 të 9 shkurtit. Pra, heshtja zgjedhore do të zgjasë vetëm gjatë 12 orëve të votimit.

Gjatë përgatitjeve për zgjedhjet e 9 shkurtit një temë prodhoi betejë ligjore: certifikimi i Listës Serbe, pasi më 23 dhjetor përfaqësuesit e Lëvizjes Vetëvendosje në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve votuan kundër certifikimit të Listës Serbe. Përfaqësuesit e partive të tjera abstenuan gjatë votimit.

Lista Serbe është partia kryesore e serbëve në Kosovë që gëzon mbështetjen e Beogradit. Kjo parti më pas u anka në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia. PZAP-ja i dha të drejtë Listës Serbe, duke mos gjetur asnjë shkelje nga kjo parti që do të përbënte bazë për moscertifikim dhe urdhëroi KQZ-në ta certifikojë këtë subjekt.

Pas hedhjes së shortit për numrat e partive, kanë reaguuar liderët politikë.

Lëvizja Vetëvendosje ka shkruar në "Facebook" se "18 është numri i 500 mijë zemrave që rrahin si një".

Ndërkaq lideri i PDK-së, Memli Krasniqi, ka thënë se numri 131 i PDK-së është numër i fitores, i besimit dhe i të ardhmes. "Partia Demokratike e Kosovës, me kandidatin tonë për kryeministër, Bedri Hamzën, dhe listën më të mirë të kandidatëve për deputetë, është e mobilizuar dhe e gatshme për fitore në zgjedhjet e 9 shkurtit.

Numri 131 na bashkon në vizionin për një Kosovë ma të mirë. Me punë të palodhshme, përkushtim të madh dhe kompetencë të dëshmuar, bashkë do të ndërtojmë një të ardhme më të mirë për çdo qytetar", ka shkruar Krasniqi në "Facebook".

Republika e Kosovës Republika Kosovo - Republic of Kosovo Komisioni Qendror i Zgjedhjeve Central Election Committee		ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS 2025 IZBORI ZA SKUPŠTINU REPUBLIKE KOSOVA 2025	
1 Shënjeni VETËM NJË subjekt politik Oznaçite SAMO JEDAN politički subjekat		2 Shënjeni DERI NË DHJETË kandidat Oznaçite DO DESET kandidata	
<input type="checkbox"/>	111 IRDK INICIATIVA E RE DEMOKRATIKE E KOSOVËS - IRDK	<input type="checkbox"/>	1
<input type="checkbox"/>	112 SRPSKA LISTA	<input type="checkbox"/>	2
<input type="checkbox"/>	113 Jedinstvena Goranska Partija	<input type="checkbox"/>	3
<input type="checkbox"/>	114 PARTIA ROME E BASHKUAR E KOSOVËS	<input type="checkbox"/>	4
<input type="checkbox"/>	115 PARTIA LIBERALE EGJIPTIANE-PLE	<input type="checkbox"/>	5
<input type="checkbox"/>	116 SRPSKA DEMOKRATIJA	<input type="checkbox"/>	6
<input type="checkbox"/>	117 Partia Balli Kombëtar Demokrat Shqiptar	<input type="checkbox"/>	7
<input type="checkbox"/>	118 Lëvizja VETËVENDOSJE!	<input type="checkbox"/>	8
<input type="checkbox"/>	119 NOVA DEMOKRATSKA STRANKA	<input type="checkbox"/>	9
<input type="checkbox"/>	120 Partija kosovskih Srba	<input type="checkbox"/>	10
<input type="checkbox"/>	121 Naša Bošnjačka Koalicija (Naša Inicijativa i Bošnjačka stranka)	<input type="checkbox"/>	11
<input type="checkbox"/>	122 Kosova Adalet Türk Partisi	<input type="checkbox"/>	12
<input type="checkbox"/>	123 PARTIA E ASHKALINJËVE PËR INTEGRIM	<input type="checkbox"/>	13
<input type="checkbox"/>	124 LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS - LDK	<input type="checkbox"/>	14
<input type="checkbox"/>	125 PDAK-LPB	<input type="checkbox"/>	15
<input type="checkbox"/>	126 GRADJANSKA INICIJATIVA NARODNA PRAVDA	<input type="checkbox"/>	16
<input type="checkbox"/>	127 SOCIJALDEMOKRATSKA UNIJA - SDU	<input type="checkbox"/>	17
<input type="checkbox"/>	128 Fatmir Bytyqi	<input type="checkbox"/>	18
<input type="checkbox"/>	129 Koalicioni për Familje	<input type="checkbox"/>	19
<input type="checkbox"/>	130 Yenilikçi Türk Hareket Partisi	<input type="checkbox"/>	20
<input type="checkbox"/>	131 PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS - PDK	<input type="checkbox"/>	21
<input type="checkbox"/>	132 Za Slobodu Pravdu i Opstanak	<input type="checkbox"/>	22
<input type="checkbox"/>	133 Srpski narodni pokret	<input type="checkbox"/>	23
<input type="checkbox"/>	134 KOSOVA DEMOKRATİK TÜRK PARTİSİ	<input type="checkbox"/>	24
<input type="checkbox"/>	135 Koalicija Vakut	<input type="checkbox"/>	25
<input type="checkbox"/>	136 Opre Roma Kosova	<input type="checkbox"/>	26
<input type="checkbox"/>	137 AAK - ALEANCA PËR ARDHMËRINË E KOSOVËS NISMA - Nisma Socialdemokrate, Konservatorët, Intelektualët	<input type="checkbox"/>	27
<input type="checkbox"/>	138 FJALA	<input type="checkbox"/>	28
		<input type="checkbox"/>	29
		<input type="checkbox"/>	30
		<input type="checkbox"/>	31
		<input type="checkbox"/>	32
		<input type="checkbox"/>	33
		<input type="checkbox"/>	34
		<input type="checkbox"/>	35
		<input type="checkbox"/>	36
		<input type="checkbox"/>	37
		<input type="checkbox"/>	38
		<input type="checkbox"/>	39
		<input type="checkbox"/>	40
		<input type="checkbox"/>	41
		<input type="checkbox"/>	42
		<input type="checkbox"/>	43
		<input type="checkbox"/>	44
		<input type="checkbox"/>	45
		<input type="checkbox"/>	46
		<input type="checkbox"/>	47
		<input type="checkbox"/>	48
		<input type="checkbox"/>	49
		<input type="checkbox"/>	50
		<input type="checkbox"/>	51
		<input type="checkbox"/>	52
		<input type="checkbox"/>	53
		<input type="checkbox"/>	54
		<input type="checkbox"/>	55
		<input type="checkbox"/>	56
		<input type="checkbox"/>	57
		<input type="checkbox"/>	58
		<input type="checkbox"/>	59
		<input type="checkbox"/>	60
		<input type="checkbox"/>	61
		<input type="checkbox"/>	62
		<input type="checkbox"/>	63
		<input type="checkbox"/>	64
		<input type="checkbox"/>	65
		<input type="checkbox"/>	66
		<input type="checkbox"/>	67
		<input type="checkbox"/>	68
		<input type="checkbox"/>	69
		<input type="checkbox"/>	70
		<input type="checkbox"/>	71
		<input type="checkbox"/>	72
		<input type="checkbox"/>	73
		<input type="checkbox"/>	74
		<input type="checkbox"/>	75
		<input type="checkbox"/>	76
		<input type="checkbox"/>	77
		<input type="checkbox"/>	78
		<input type="checkbox"/>	79
		<input type="checkbox"/>	80
		<input type="checkbox"/>	81
		<input type="checkbox"/>	82
		<input type="checkbox"/>	83
		<input type="checkbox"/>	84
		<input type="checkbox"/>	85
		<input type="checkbox"/>	86
		<input type="checkbox"/>	87
		<input type="checkbox"/>	88
		<input type="checkbox"/>	89
		<input type="checkbox"/>	90
		<input type="checkbox"/>	91
		<input type="checkbox"/>	92
		<input type="checkbox"/>	93
		<input type="checkbox"/>	94
		<input type="checkbox"/>	95
		<input type="checkbox"/>	96
		<input type="checkbox"/>	97
		<input type="checkbox"/>	98
		<input type="checkbox"/>	99
		<input type="checkbox"/>	100
		<input type="checkbox"/>	101
		<input type="checkbox"/>	102
		<input type="checkbox"/>	103
		<input type="checkbox"/>	104
		<input type="checkbox"/>	105
		<input type="checkbox"/>	106
		<input type="checkbox"/>	107
		<input type="checkbox"/>	108
		<input type="checkbox"/>	109
		<input type="checkbox"/>	110

Lideri i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka thënë se 9 shkurti është fitorja e tyre. "9 shkurti është fati jonë, thirrja jonë, fitorja jonë!", ka shkruar Abdixhiku.

Kurse lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se me numrin 137, më 9 shkurt, janë Aleanca - Nisma - Konservatorët - Forumi Intelektual E-30 dhe Lista Ideal. "Në numrin 137 është fitorja e Kosovës", ka shkruar Haradinaj.

Pas përfundimit të regjistrimit të votuesve jashtë vendit, KQZ-ja bëri me dije se numri i votuesve për zgjedhjet e 9 shkurtit do të jetë 2 milionë e 75 mijë e 868 votues brenda dhe jashtë Kosovës.

Votuesit jashtë vendit, përveç votimit me postë, për herë të parë do të mund të votojnë në 17 ambasada dhe 15 konsullata në 19 shtete të ndryshme të botës.

Votimi me postë nga jashtë vendit nis më 9 janar.

Sipas KQZ-së, për votim jashtë vendit janë regjistruar 104 924. Nga ta, 20 399 janë regjistruar për votim fizik në ndonjë nga përfaqësitë diplomatike, të tjerët për votim me postë.

Kryeziu: Fushata zgjedhore dhe mundësia për të parë përtej premtimeve!

Drejtori i Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), Ismet Kryeziu, ka thënë se tani që po i afrohem fillimit zyrtar të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e 9 shkurtit 2025, interesi ynë si qytetarë është të shohim përtej

fjalëve të bukura dhe të analizojmë politikat konkrete të subjekteve politike dhe kandidatëve e kandidateve që garojnë për të fituar besimin tonë. "Fushata zgjedhore nuk duhet të jetë retorikë boshe e fontanë dëshirash e as rebelim. Ajo duhet të jetë diskutim dhe prezantim i ideve konkrete mbi nevojat e qytetarëve. Me rreth 1300 kandidatë e kandidate në garë, duhet të pyesim?! Çfarë kanë bërë dhe çfarë po bëjnë ata për komunitetin tonë? Cilat janë prioritetet e tyre reale? Pse po e kërkojnë votën tonë dhe si planifikojnë të na shërbejnë? Fushata zgjedhore është momenti më i mirë për të kërkuar llogaridhënie dhe për të kërkuar plane të qarta e veprime konkrete që adresojnë nevojat tona si qytetarë", ka shkruar në "Facebook" Kryeziu.

Limaj: Koalicioni AAK-Nisma përfaqëson të gjitha shtresat e shoqërisë



PRISHTINË, 8 JANAR - Koalicioni AAK-Nisma dhe të tjerët përmes një njoftimi për medie ka njoftuar se mbetet i angazhuar vazhdimisht në aktivitete të ndryshme, duke zhvilluar biseda dhe bashkëpunim me të gjitha segmentet e shoqërisë - sindikatat, shoqatat, diasporën dhe çdo sektor

tjetër. “Kosova ka vetëm një koalicion të madh, një koalicion që përfaqëson koordinim të jashtëzakonshëm dhe përfshirje të të gjitha shtresave të shoqërisë. Nga siguria energjetike dhe anëtarësimi në NATO deri të mbrojtja e vlerave familjare, këto janë themelet që i garantojnë

qytetarët tanë një të ardhme më të sigurt”, ka thënë lideri i Nismës, Fatmir Limaj. Ai ka thënë se dëshmitë për veprat që kanë realizuar janë prova të qarta të angazhimit dhe përkushtimit tonë për vendin. “Ky muaj është një mundësi për të gjithë qytetarët që të vlerësojnë përpjekjet tona dhe të mos lejojnë që

shpifjet, mashtrimet dhe gjuha e urrejtjes të ndikojnë në kursin e Kosovës. Koha është për të vlerësuar subjektet politike që kanë vepra konkrete, jo fjalë të thëna pa argumente. Ne angazhohemi për zgjedhje të lira dhe të drejta, duke ballafaquar me fakte dhe argumente të forta, dhe duke ftuar të gjitha grupet

politike për të respektuar rregullat dhe ligjet. Një falënderim i veçantë shkon për të gjitha strukturat, aktivistët dhe qytetarët e Kosovës, për punën dhe angazhimin e tyre të pandalur, që po bëjnë për ta rikthyer Kosovën në rrugën e fitores. Veç vepra do të përcaktojë të ardhmen tonë”, ka thënë Limaj.

Zyrtari i lartë amerikan nis vizitën zyrtare në Ballkan

TIRANË, 8 JANAR - Zëvendëssekretari amerikan i Shtetit për Menaxhimin dhe Burimet, Richard Verma, ka mbërritur në Shqipëri mërkurën. Më të arritur në Shqipëri, ai ka thënë se do të takohet me partnerët e ShBA-së të cilët janë të angazhuar për forcimin e demokracisë dhe sigurisë. “Sapo mbërrita në Shqipëri dhe e bukur! I lumtur që të nis vizitën time dhe të punoj me partnerët tanë në forcimin e demokracisë, sigurisë dhe mbështetjen e atyre që janë në nevojë”, ka thënë Verma. Pas Shqipërisë, Verma do ta vizitojë dhe Kosovën. Në Kosovë, ai do të diskutojë për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë përmes dialogut të lehtësuar nga BE-ja. Po ashtu, ai do të diskutojë për forcimin e qeverisjes dhe

sundimin e ligjit, dhe nxitjen e rritjes ekonomike dhe sigurisë energjetike për qytetarët kosovarë. Gjithashtu, Verma do të falënderojë Qeverinë e Kosovës për mbështetjen e saj të fuqishme ndaj Ukrainës dhe për ndihmën e ofruar afganëve në nevojë. Gjatë vizitës në Tiranë, Verma do të diskutojë përparimin demokratik të Shqipërisë, aftësitë mbrojtëse të vendit, si dhe thellimin e lidhjeve ekonomike me Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA). Ndërsa në Serbi, Verma pritet të diskutojë për normalizimin e marrëdhënieve me Kosovën. Kjo vizitë reflekton angazhimin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) për të promovuar stabilitetin, demokracinë dhe bashkëpunimin ekonomik në rajonin e Ballkanit Perëndimor.



A ka pasur “efekt pozitiv” heqja e dinarit në sistemin financiar të Kosovës?

PRISHTINË, 8 JANAR - Rregullorja e Bankës Qendrore të Kosovës që transaksionet financiare të kryhen vetëm në euro, nuk e ka arritur qëllimin e saj, pasi valuta e Serbisë, dinari ende qarkullon në zonat serbe në Kosovë dhe të ardhurat nga buxheti i Serbisë nuk konvertohen në euro, thotë për “Radion Evropa e Lirë” (REL) profesori i ekonomisë në Universitetin e Prishtinës, Mejdi Bektashi. “Kjo rregullore ishte një vendim i nxituar. Një vendim politik i kësaj Qeverie”, mendon ai dhe shton se çështja e heqjes së dinarit duhej të zgjidhej nëpërmjet dialogut për normalizimin e marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë, i ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian.

Bektashi thekson se edhe pas një viti nga miratimi i rregullores, nuk ekzistonin një marrëveshje për transferimin e parave që do t'i siguronte Bankës Qendrore të Kosovës qasje në këto fonde.

Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Ahmet Ismaili, duke komentuar këtë rregullore në konferencën vjetore në fund të dhjetorit, tha se ajo ka pasur një “efekt pozitiv” në të gjithë sektorin financiar, duke sjellë “unifikimin e sektorit dhe ndërprerjen e financimeve të paligjshme”.

Rregullorja, e cila ndalon pagesat me valuta të tjera pos euros - rrjedhimisht edhe me dinarë - u miratua në fund të dhjetorit 2023 dhe hyri në fuqi më 1 shkurt 2024.

Pjesëtarët e komunitetit serb, të cilët marrin të ardhura të ndryshme nga buxheti i Serbisë

në dinarë, reagon ashpër ndaj kësaj rregulloreje, ndërsa ajo u kritikua edhe nga komuniteti ndërkombëtar me arsyetimin se mund të ketë pasojë negative për komunitetet pakicë.

Profesor Bektashi thotë se e vetmja gjë që ka ndryshuar gjatë këtij viti është se qytetarët e Kosovës nga komuniteti serb duhet të shkojnë në Serbi për t'i marrë të ardhurat e tyre në dinarë. “Periudha e tranzicionit duhej të kishte një kuptim, që Banka Qendrore e Kosovës dhe Banka Popullore e Serbisë të arrinin një marrëveshje për konvertimin e dinarit në euro dhe të sigurohej qarkullimi i parave për pensionistët dhe të tjerët që marrin të ardhura në dinarë”, konsideron Bektashi.

Banka Popullore e Serbisë ka insistuar që çështja e dinarit të diskutohet në kuadër të dialogut, gjë që Kosova përgjithësisht e ka refuzuar, duke argumentuar se kjo është çështje e brendshme.

Cila është gjendja reale në terren?

Petar nga Mitrovica e Veriut është punëtor i një prej institucioneve të mbyllura, që funksiononin sipas sistemit serb, të cilat Kosova i ka mbyllur me arsyetimin se “funksiononin në mënyrë të paligjshme”. Në një bisedë për “Radion Evropa e Lirë”, Petari thotë se aktualisht nuk shkon në punë, porse pagën e merr rregullisht. “Paga më transferohet në një llogari që është në dinarë. Ndoshta edhe kjo duhej të zgjidhej, që paga të konvertohej disi dhe ta merrnim



normalisht në euro në Kosovë, përmes bankave si NLB Banka ose Raiffeisen Banka, që ndodhen në qytetin tonë”, thotë ky qytetar.

Ai vëren se “asnjëra palë nuk dëshiron t'i kushtojë vëmendje popullit që po kalon nëpër vështirësi”.

Banka Qendrore e Kosovës ka pohuar se heqja e transaksioneve financiare në dinarë nuk e ndalon pagesën e të ardhurave nga buxheti i Serbisë, por ato duhet të jenë ekskluzivisht në euro, për të mundësuar qasjen në rrjedhën e parasë.

Megjithatë, deri më sot, këto të ardhura kanë mbetur në dinarë. Gjithashtu, në disa zona serbe - kryesisht në komunat në veri - dinari vazhdon të qarkullojë si mjet pagese në objektet tregtare.

Beogradi zyrtar refuzon t'i mbyllë institucionet e veta në Kosovë, dhe disa prej tyre janë

transferuar në vendet kufitare në Serbi. Aty janë vendosur edhe bankomatë, prej nga qytetarët e Kosovës tërheqin të ardhurat e tyre në dinarë.

“Për dinarë, në Serbi”

Radomiri nga Leposaviqi thotë se tani, “si zakonisht”, i tërheq të ardhurat e tij në dinarë në Rashkë, një qytet kufitar në Serbi, rreth 30 kilometra larg kësaj komune me shumicë serbe në veri të Kosovës. “Zakonisht shkojmë atje (në Rashkë) dhe blejmë edhe produkte serbe që këtu (në Kosovë) ishin të ndaluara për një periudhë. Jemi mësuar të paguajmë edhe me kartelë... në përgjithësi, nuk është shumë e thjeshtë, por po përshtatemi”, thotë ai.

Ai vë në dukje se në pikat kufitare krijohen radhë të gjata gjatë kohës kur bëhen pagesat nga buxheti i Serbisë, dhe

shpesh ndodh të presin për disa orë për të kaluar nga Kosova në Serbi ose anasjelltas. “Duhet të armatoseh me durim, sepse krijohen turma të mëdha kur bëhet pagesa e pensioneve ose ndonjë e ardhur tjetër. Në familje kam dy pensionistë (prindërit), i kam çuar në Rashkë, por tani kam marrë një autorizim dhe ua tërheq pensionet vetë”, tregon Radomiri.

Miloradi nga Graçanica, një komunë me shumicë serbe pranë Prishtinës, deri në heqjen e dinarit e merrte pensionin me çek, pra paratë i jepeshin në sportelin e Postës që funksiononte në sistemin serb ose i dërgoheshin në adresën e shtëpisë nga postieri.

Ai shpjegon se në muajt e parë pas ndalimit të përdorimit të dinarit, shkonte çdo muaj në Serbi për ta tërhequr pensionin, por më pas ka hapur një llogari në bankën e Kursimores së Postës serbe, ku i transferohen paratë.

Tani, siç thotë, kartën bankare ua jep fëmijëve të tij, të cilët e tërheqin pensionin e tij në Serbi.

Çdo vit Serbia ndan miliona euro për pagesën e të ardhurave për serbët në Kosovë.

Përveç pagave dhe pensioneve, aty përfshihen edhe ndihmat financiare si asistenca sociale, shtesat për fëmijë dhe të ngjashme. Në fund të tetorit të vitit 2024, Qeveria e Serbisë shpalli territorin e Kosovës si “zonë të mbrojtjes së veçantë sociale”, gjë që parashikon ndihmë shtesë financiare për të papunët, pensionistët dhe fëmijët.

PDK-ja me mbi 1,700 tubime anembanë Kosovës

PRISHTINË, 7 JANAR - Partia Demokratike e Kosovës (131) ka mbajtur një konferencë për medie, ku janë prezantuar planet dhe vizioni për zgjedhjet e përgjithshme të 9 shkurtit.

Vlora Çitaku, sekretare e Përgjithshme e PDK-së, tha se PDK-ja është mobilizuar dhe e përgatitur për të udhëhequr Kosovën drejt një të ardhmeje më të mirë. “Kandidatët tanë dhe strukturat tona në terren kanë punuar paqeshtur për t'u siguruar se çdo qytetar do të përfaqësohet denjësisht”, tha Çitaku.

Çitaku njoftoi se gjatë fushatës, PDK-ja do të mbajë mbi 1,700 tubime me qytetarët anembanë Kosovës, ku do të prezantohet programi dhe vizioni i saj.

Ajo gjithashtu ftoi qytetarët të marrin pjesë në hapjen zyrtare të fushatës, më 11 janar në sallën “1 Tetori” në Prishtinë nga



ora 16:30, duke e cilësuar këtë aktivitet si një festë e unitetit dhe shpresës. “PDK është e bindur në leadershipin dhe

programin e saj, duke besuar se ofron kandidatin më të mirë për kryeministër dhe listën më të kualifikuar të kandidatëve për

deputetë”, tha Çitaku. Sekretarja e Përgjithshme njoftoi gjithashtu se Blerand Stavileci është caktuar si

zëdhënës zyrtar i fushatës, i mbështetur nga nënkryetarja Besianë Musmurati. “Angazhimi ynë për transparencë dhe bashkëpunim me mediat do të jetë prioritet. Vlerësojmë lart rolin e gazetarëve në demokracinë tonë dhe premtojmë bashkëpunim të plotë gjatë gjithë fushatës”, tha zëdhënësi zyrtar i fushatës, Blerand Stavileci.

Ai theksoi se këto zgjedhje janë një mundësi për ta formësuar të ardhmen e Kosovës dhe për të adresuar nevojat reale të qytetarëve. “Zyra e komunikimit të PDK-së do të sigurojë qasje të plotë për mediat, duke garantuar informim të vazhdueshëm dhe korrekt”, tha ai.

PDK-ja fton qytetarët e Kosovës të bashkohen nën numrin 131 për një Kosovë më të fortë, më të drejtë dhe ma të mirë.

Morën pjesë në aktivitete partiake, suspendohen tre zyrtarë policorë

PRISHTINË, 8 JANAR - Policia e Kosovës (PK), bazuar në Ligjin e Policisë së Kosovës i cili përcakton konfliktin e interesave, udhëzimin administrativ për shkeljet, masat dhe procedurat disiplinore në Policinë e Kosovës si dhe rekomandimin e Inspektoratit Policor të Kosovës, ka suspenduar dy zyrtarë policorë, përderisa IPK-

ja ka suspenduar një zyrtar policor, (të suspenduar janë një kolonel, një major dhe një rreshter policor). Suspendimi i zyrtarëve policorë është bërë mbi dyshimin për pjesëmarrje në tubim apo aktivitete të natyrës politike, të cilat bien në kundërshtim me procedurat ligjore si dhe udhëzimet e brendshme të PK-së. "Policia e Kosovës, si

institucion i zbatimit të ligjit, mbetet e përkushtuar në realizimin e detyrave dhe autorizimeve ligjore e kushtetuese, si institucioni kyç për garantimin e rendit dhe sigurisë për të gjithë qytetarët pa dallim. Me qëllim të ruajtjes së besimit të publikut, ruajtjes së imazhit të Policisë si një ndër institucionet më të besuara dhe transparente, Policia e

Kosovës mbetet e përkushtuar në ruajtjen e vlerave, integritetit dhe profesionalizmit të saj, duke shërbyer në mënyrë të drejtë dhe të paanshme Policia e Kosovës me gjithë zyrtarët saj, kanë detyrë primare garantimin e rendit dhe sigurisë për të gjithë qytetarët dhe çdo përfshirje e zyrtarëve policorë në aktivitete politike



mund të dëmtojë besimin e krijuar ndër vite ndaj Policisë së Kosovës", ka njoftuar Policia e Kosovës.

Kosova mbyll edhe dy institucione serbe në veri

PRISHTINË, 8 JANAR - Policia e Kosovës më 8 janar mbylli Administratën Tatimore në Mitrovicën e Veriut, e cila funksiononte në kuadër të sistemit të Serbisë, për shkak të "aktiviteteve të paligjshme", si dhe kompaninë sigurimesh nga Serbia - Dunav Osiguranje, për shkak të dyshimeve se punonte pa licencë.

Lista Serbe njoftoi se me mbylljen e Administratës Tatimore, 80 punëtorë "kanë mbetur në rrugë", dhe e akuzoi kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, se po vazhdon fushatën zgjedhore "në kurriz të popullit serb", para zgjedhjeve parlamentare të 9 shkurtit. Zëvendës drejtori i Policisë së Kosovës për rajonin e veriut, Veton Elshani, i tha Radios Evropa e Lirë se për rastin e Administratës Tatimore është informuar prokurori kujdestar dhe se punonjësve u është lejuar të marrin vetëm sendet e tyre personale.

Ndërsa, lidhur me kompaninë sigurimesh, ai tha se policia në këtë aksion asistoi zyrtarët e Bankës Qendrore të Kosovës, dhe se prokurori e cilësoi rastin si "shpërdorim të veprimtarisë ekonomike".

Dunav Osiguranje është një shoqëri aksionare nga Serbia, e cila ofron mbi 100 shërbime në fushën e sigurimeve të jetës dhe të pasurisë. Në faqen e saj zyrtare, në listën e adresave të



degëve përfshihet edhe ajo në Mitrovicën e Veriut, në veri të Kosovës.

Mbyllja e tyre është vazhdim i aksioneve për mbylljen e institucioneve të Serbisë në Kosovë, të cilat autoritetet zyrtare të Prishtinës i konsiderojnë "të paligjshme".

Ministri i Punëve të Brendshme të Kosovës, Xhelal Sveçla, ka shkruar në profilin e tij në Facebook se "aktiviteti ilegal i

Agjencionit Tatimor të Serbisë do të hetohet nga të gjithë mekanizmat tanë institucional, ndërsa ne do të vazhdojmë të luftojmë çdo paralelizëm kriminal të Serbisë përballë institucioneve tona". "Ky institucion ka mbledhur ilegalisht mjete financiare nga qytetarë e subjekte që jetojnë e vepron në Republikën e Kosovës. Haraçi është i dënueshëm dhe rreptsisht i

ndaluar për këdo që e zhvillon atë", tha ai.

Nga ana tjetër, Lista Serbe njoftoi se gjatë ditës do të bisedojë me punonjësit e Administratës Tatimore dhe për mundësitë e ndihmës dhe mbështetjes. "Asnjëri prej tyre nuk do të mbetet pa paga dhe të ardhura dhe ekzistenca e tyre do të mbetet e siguruar", thuhet në njoftimin e Listës Serbe, partia më e madhe e serbëve në

Kosovë, e cila ka mbështetjen e Beogradit.

Kosova filloi mbylljen e institucioneve serbe në janar të vitit 2024 dhe deri më tani janë mbyllur një numër komunash paralele serbe në Dragash, Suharekë, Prizren, Rahovec, Pejë, Istog, Klinë, Skenderaj, Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq. Gjithashtu, janë mbyllur edhe Posta e Serbisë në veri të Kosovës, Thesari i Bankës Kombëtare të Serbisë në Leposaviq, Banka e Kursimeve Postare, Zyra për Kosovën e Qeverisë së Serbisë, Drejtoria e Fondit të Sigurimeve Pensionale dhe Invalidore, Qarku Administrativ i Mitrovicës së Kosovës dhe Qendra për Punë Sociale në Vushtrri, Drejtoria e Urbanizmit, Drejtoria e Hapësirave të Banimit dhe Biznesit dhe Drejtoria për Tokën Ndërtimore në Mitrovicën e Veriut.

Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, në një adresim publik në mes të shtatorit të vitit të kaluar, tha se me mbylljen e institucioneve serbe në Kosovë, rreth 5.800 persona kanë mbetur pa vendet e tyre të punës, por se ata do të vazhdojnë të marrin paga. Serbia refuzon të shuajë institucionet e saj për territorin e Kosovës dhe shumicën prej tyre i ka zhvendosur pranë pikave kufitare nga ana serbe.

Tallja e radhës e Bashkimit Evropian me qeverinë Kurti

PRISHTINË, 8 JANAR - Profesori universitar, Milazim Krasniqi, ka thënë se kërkesa e Bashkimit Evropian që Kuvendi i Kosovës ta miratojë ligjin për bashkësitë fetare, në kontekstin e rregullimit të statusit të Kishës Ortodokse Serbe, duket si tallje e radhës. "Ata janë mësuar të tallen me qeverinë Kurti, sepse kjo qeveri nuk e kupton. Prandaj po tallen me të. Për tallje me Kurtin, çështjen e Kishës e kanë futur edhe në Marrëveshjen bazike, edhe pse nuk e ka vendin as aty. Pse? Sepse edhe në Serbi shteti e Kisha janë të ndara prandaj shteti nuk mund të marrë përsipër ingerencat e Kishës.

Nga ana tjetër, për ta kompletuar paditurinë e vet në këtë çështje, Albin Kurti ka pasë deklaruar se statusi i Kishës Ortodokse Serbe do të zgjidhet me Ligjin për Liritë Fetare. Qesharake. Mirerabile", ka shkruar Krasniqi në "Facebook".

Ai ka thënë se: "Nëse sillemi si shtet sovran, raportit me Kishën Ortodokse Serbe nuk zgjidhet vetëm me ligjin tonë, sepse Kisha është agjentë jashtë shtetit të Kosovës. (Edhe me Vatikanin shtetet sovraane i rregullojnë raportet me anën e Konkordatit.) Raportin me Kishën Serbe Kosova duhet ta zgjidhë në mënyrë standarde,

si shtetet e tjera sovraane, fjala vjen, si Kroacia, me anën e një Marrëveshjeje Themeltare. (Temeljni ugovor, ose vetëm Ugovor." "Pse bre nuk e merrni atë marrëveshje kroate të vitit 2003 dhe ta përshtatni? Ama për ta marrë atë model, fillimisht duhet të silleni si qeveri e një shteti sovran. Nëse do të sillleshit ashtu, do ta kuptonit se raportit i shtetit sovran me KOS nuk rregullohet me ligjin që vlen për bashkësitë që janë vetëm brenda Kosovës. Fillimisht duhet një Marrëveshjeje Themeltare me Kishën Ortodokse Serbe (jo me Serbinë.) Kuptoni more, se na fikët!", ka shkruar Krasniqi.



Naftëtarët dhe ndërtimtaria nën llupën e MINT-it

PRISHTINË, 8 JANAR - Nën llupën e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë janë naftëtarët, prodhuesit e produkteve të ndërtimit dhe disa sektorë të tjerë në vend.

Rozeta Hajdari, ministre e MINT-it, thotë se një nga detyrat kryesore të kësaj ministrie është mbrojtja e konsumatorëve nga abuzimet me çmimet dhe cilësinë e produkteve, duke siguruar një mbikëqyrje strikte, si dhe duke ndërmarrë masa për të parandaluar manipulimin e çmimeve që mund të shkaktojnë dëm për qytetarët.

Në një intervistë për KosovaPress, Rozeta Hajdari flet edhe për raportet tregtare në vendin tonë, si dhe për investimet e huaja direkte gjatë vitit 2024.

Ajo madje thotë se ka përmirësim të bilancit tregtar eksport-import. "Kemi dyfishim të eksportit dhe përmirësim të

bilancit tregtar nga raporti eksport-import nga një me nëntë e një me gjashtë. Kemi dyfishim të investimeve të huaja direkte gjatë këtij mandati", thotë Hajdari.

Sa i përket monitorimit të tregut, ministrja Hajdari thotë se ndërhyrjet më të mëdha kanë qenë në tregun e naftës, për çka shton se afër 50 për qind e operatorëve ekonomik kanë qenë të palicencuar në tregun e naftës. "Për herë të parë në Republikën e Kosovës kemi filluar me mbikëqyrjen efektive të produkteve të ndërtimit me qëllim që të sigurojmë cilësinë e ndërtimeve të larta banesore, rregullimin, mbikëqyrjen e tregut, të produkteve të naftës, formalizmin e bizneseve në fushën e tregtisë në naftë, rritjen e kontrollimit të cilësisë së naftës dhe mbrojtjen e konsumatorëve nga abuzimet me çmimet me inflacion. Janë afër 12 mijë inspektime gjatë



mandatit tonë qeverisës nga periudha mars 2021 - shtator 2024 në krahasim me periudhën paraprake që ishte në vitin

2017-2020. Kryesisht ndërhyrjet më të larta kanë qenë në tregun e naftës, ku kemi gjetur shumë operator ekonomik të pa

licencuar, afër 50 për qind të operatorëve ekonomik kanë qenë të palicencuar në tregun e naftës", shton Hajdari.

Ulet çmimi i energjisë për konsumatorët familjarë në Shqipëri

TIRANË, 8 JANAR - Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE) është mbledhur të mërkurën për të shqyrtuar kërkesën e Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) për uljen e çmimit të energjisë për familjarët.

Drejtori i tarifave pranë OSHEE-së, Romir Pajenga, ka thënë se çmimet për konsumatorët familjarë që shpenzojnë deri në 700 kwh, çmimi do të jetë 8.5 lekë për kilovat. Për ato familje që konsumojnë më shumë se 700 kilovat, çmimi do të jetë 9.5 lekë për kilovat. Ku vendim do të hyjë në fuqi më 1 shkurt 2025 deri në 31 dhjetor 2025.

Me këtë rast, kryeministri Edi Rama, ka thënë se kjo është ulja e parë në historinë e këtyre 35 viteve të çmimit të energjisë elektrike. "Ky është një fakt i cili na mbush patjetër me shumë krenari, po të marrim parasysh se nga çfarë humnere e kemi nisur ngjitjen deri në këtë pikë", ka thënë Rama në një



konferencë për medie së bashku me zëvendëskryeministren dhe njëherësh ministre e

Infrastrukturës dhe Energjisë, Belinda Balluku. "Po të marrim parasysh se ulja e çmimit të

energjisë elektrike në kohën e sotme është në kundërtendencë të plotë me rajonin dhe me

kontinentin ku jetojmë, ku çmimet e energjisë elektrike jo vetëm janë rritur në përgjithësi, por janë të kërcënuar nga rritje të tjera. Kjo masë, është një masë më shumë sesa e mirëmenduar, e diskutuar gjerësisht në të gjitha nivelet me ekspertizën e brendshme dhe me ekspertizë ndërkombëtare. E bazuar në projeksionet e planit tonë strategjik për sovranitetin e plotë energjetik dhe kthimin e Shqipërisë në një eksportuese neto të energjisë brenda mandatit tonë të katërt dhe sigurisht duke pasur parasysh edhe parimin e shpallur botërisht të qeverisë sonë për të ndarë me qytetarët frytet e reformave të dhimbshme, frytet e përpjekjeve shumë të mundimshme në këto vite dhe frytet e një rritjeje ekonomike, që për vitin 2025 e parashohim në harkun e 4 për qind, që është një shifër shumë domethënëse", ka thënë Rama.

Durmishi: Ura e Badocit është stabile

PRISHTINË, 8 JANAR - Zëvendëskryeministri i Infrastrukturës, Hysen Durmishi, ka deklaruar se ura e Badocit është stabile. Kjo deklaratë e Durmishit vjen pas disa reagimeve që janë bërë ditën e martë, ku ka pasur kritika se kjo urë është lëshuar për qarkullim pa u testuar. "Ura e Badocit është stabile. Dje dhe sot po mundohen të ngjallin pasiguri te qytetarët

me rastin e hapjes së urës së Badocit. Ura e Badocit është projektuar e ndërtuar me standardet më të larta të projektimit e ndërtimit", ka shkruar ai në "Facebook".

Ai ka bërë me dije se gjatë të gjitha fazave janë kryer inspektimet profesionale, përfshirë këtu atestet paraprake të materialeve, testimet të vazhdueshme të

betonit e armaturës deri në finalizimin e saj. "Prandaj me përgjegjësi të lartë profesionale deklaroj se ura e Badocit është shumë stabile. Gjatë gjithë këtyre ditëve aty kanë kaluar shumë makineri me pesha të rënda pa asnjë problem për urën, e këtë do ta dëshmojë edhe testimi formal që do të bëhet nesër", ka thënë Durmishi.



Marrëveshja me SpaceX: Italia, 1.5 miliardë Euro për satelitët e Elon Musk

Qeveria italiane po përgatitet të firmosë një marrëveshje pesëvjeçare me kompaninë SpaceX të Elon Musk, me vlerë 1.5 miliardë euro, për të siguruar komunikime të sigurta për shtetin italian. Sipas raportimeve nga Bloomberg, ky projekt përfshin një gamë të gjerë shërbimesh, nga kriptografia e avancuar për telefoninë dhe internetin qeveritar, deri te shërbime komunikimi për ushtrinë italiane në zonën e Mesdheut.

Investim strategjik

Marrëveshja e propozuar parashikon edhe përdorimin e Starlink, rrjeti i satelitëve të Musk, për të garantuar lidhje të shpejtë interneti në të gjithë territorin italian. Për më tepër, satelitët direct-to-cell do të mundësojnë komunikime në situata emergjence, si sulme terroriste apo katastrofa natyrore.

Ky investim shihet si një hap i rëndësishëm për modernizimin e infrastrukturës teknologjike dhe të sigurisë kombëtare të Italisë. Duke pasur parasysh

kostot e larta të alternativave të tjera (vlerësuar deri në 10 miliardë euro), marrëveshja me SpaceX ofron një kursim të konsiderueshëm prej të paktën 8.5 miliardë eurosh.

Skepticizmi

Megjithatë, jo të gjithë në Itali janë entuziastë për këtë projekt. Disa zyrtarë kanë shprehur shqetësime mbi ndikimin që kjo marrëveshje mund të ketë mbi operatorët lokalë të telekomunikacionit. Industria italiane e telekomunikacionit është një nga më konkurrueset në botë, por ajo përballet me vështirësi financiare dhe një valë të re bashkimesh dhe shitjesh. Për shembull, në vitin 2023, Telecom Italia SpA shiti rrjetin e saj fiks për 22 miliardë euro për të ulur borxhet.

Meloni, Musk e Trump

Kryeministrja italiane, Giorgia Meloni, ka krijuar një marrëdhënie të ngushtë me Elon Musk dhe Donald Trump, i cili pritet të rikthehet si



president i SHBA-së. Bloomberg raporton se vizita e fundit e Meloni në Mar-a-Lago ka ndihmuar në përparimin e negociatave me SpaceX. Burime pranë Trump-it theksojnë se krijimi i Space Force gjatë administratës së tij, si degë e forcave të armatosura për konflikte hapësinore,

reflekton interesin për të forcuar këtë sektor. Kjo mund të përmirësojë më tej marrëdhëniet midis Romës dhe Uashingtonit, duke e bërë bashkëpunimin me kompanitë e Musk një aset strategjik. Nëse finalizohet, kjo marrëveshje do të shënojë një pikë kthese për Italinë në

përdorimin e teknologjisë së avancuar për qëllime të sigurisë dhe zhvillimit ekonomik. Megjithatë, mbeten pikëpyetje mbi pushtetin që Musk do të fitojë mbi infrastrukturën kritike italiane dhe ndikimin që kjo do të ketë mbi sovranitetin kombëtar. / bota.al

“Mos ha karremin!” Kancelari Scholz ka këtë përgjigje për Elon Musk

Kur kancelari gjerman, Olaf Scholz, u pyet gjatë një interviste mbi sulmet e ashpra dhe komentet fyese të drejtuara ndaj tij dhe liderëve të tjerë gjermanë nga Elon Musk, njeriu më i pasur në botë, ai u përgjigj shkurtimisht: “Nuk e ha karremin!”

Duke folur për revistën gjermane Stern, Scholz e cilësoi kritikën si një fenomen të njohur. “Duhet ruajtur qetësia,” tha ai. “Si socialdemokratë, jemi mësuar prej kohësh që ka sipërmarrës të pasur mediatikë që nuk vlerësojnë politikën tona dhe nuk e fshehin këtë.”

Kancelari tha se nuk do të përpiqet të ndërveprojë me Musk, i cili ka shprehur hapur mbështetjen për partinë e ekstremit të djathtë AfD (Alternativa për Gjermaninë) në zgjedhjet federale të muajit të ardhshëm dhe ka planifikuar të mbajë një bisedë të drejtpërdrejtë në platformën e tij sociale X me kandidaten e AfD-së për kancelare, Alice Weidel.

“Nuk besoj në idenë e afrimit me Musk. Jam i lumtur t’ua lë këtë të tjerëve,” deklaroi Scholz. “Rregulli është: mos ha karremin!”

Kjo ishte përgjigja më e drejtpërdrejtë e Scholz ndaj Musk, disa ditë pasi kancelari u bëri thirrje votuesve të mos lejojnë që “pronarët e kanaleve të mediave sociale” të ndikojnë në rezultatin e zgjedhjeve të

përgjithshme. Në fjalimin e tij të fundvitit, Scholz nuk e përmendi Musk me emër, as platformën e tij X.

Musk dhe ndikimi i tij politik në Europë

Që kur mori drejtimin e X, Musk ka përdorur ndikimin global të platformës për të promovuar pikëpamjet e tij politike. Pasi investoi çerek miliardë dollarë për të ndihmuar kthimin e Donald Trump në Shtëpinë e Bardhë, Musk ka mbështetur partitë e ekstremit të djathtë dhe anti-establishment në Europë, ndërsa ka sulmuar disa prej liderëve më të njohur të qendrës së majtë.

Në nëntor, pas shpërbërjes së koalicionit qeverisës të Scholz, Musk e quajti kancelarin një “budalla” në X, duke përsëritur këtë kritikë pas një sulmi në një treg Krishtlindjesh, që shkaktoi pesë të vdekur dhe mbi 200 të plagosur.

Ndërsa viti 2024 po mbyllet, Musk deklaroi se Scholz do të humbasë zgjedhjet: “Kancelari Oaf Schitz, ose sido që ai quhet, do të humbasë.”

Mbështetja për AfD

Mbështetja e Musk për AfD ka shkakuar zemërim në Gjermani dhe akuza për ndërhyrje në politikën kombëtare. Në



postimet e tij, Musk ka deklaruar se vetëm AfD mund ta shpëtojë Gjermaninë. Kjo parti është përjashtuar nga grupimet parlamentare europiane për shkak të deklaratave kontroverze, përfshirë një koment që sugjeronte se SS naziste nuk përbëheshin tërësisht nga kriminelë.

Musk ka mbështetur hapur figura dhe qeveri të tjera të ekstremit të djathtë në Europë, përfshirë kryeministren italiane Giorgia Meloni dhe kryeministrin hungarez Viktor Orbán, duke shkakuar reagime

të shumta. Në intervistën e tij, Scholz shprehu shqetësimin për përfshirjen e Musk në politikën gjermane. “Më shqetësojnë se fyerjet janë mbështetja e tij për AfD, një parti pjesërisht ekstremiste që kërkon afrim me Rusinë dhe dëshiron të dobësojë marrëdhëniet transatlantike,” tha ai.

Scholz gjithashtu mbrojti presidentin federal gjerman, Frank-Walter Steinmeier, të cilin Musk e quajti muajin e kaluar një “tiran anti-demokratik”. “Presidenti

gjerman nuk është një tiran anti-demokratik dhe Gjermania mbetet një demokraci e fortë dhe e qëndrueshme, pavarësisht çfarë thotë zoti Musk,” theksoi Scholz.

Përplasja midis kancelarit Scholz dhe Elon Musk reflekton tensionet gjithnjë e më të thella midis politikës dhe ndikimit të miliarderëve.

Ndërsa Gjermania i afrohet zgjedhjeve, ndërhyrjet e Musk kanë hapur një debat të ri mbi kufijtë e pranueshëm të ndikimit të huaj në proceset demokratike. / bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Taulant Xhaka shpallet lojtari me saktësinë më të lartë në pasime, Ragip Xhaka: Shembull për të gjithë

CYRIH, 8 JANAR (ER) - Mesfushori shqiptar i Baselit, Taulant Xhaka është shpallur si lojtari me saktësinë më të lartë në pasime në Superligën Zvicerane. 33-vjeçari ka asistuar sakët në 93.6%, derisa pas këtij sukcesi është shprehur krenar babai i Taulantit, Ragip Xhaka. Ky i

fundit ka thënë se Taulanti ka treguar vazhdimisht se është një lider në fushë, duke mbajtur lart jo vetëm emrin e tij, por edhe krenarinë e familjes dhe të gjithë shqiptarëve. “Me krenari të veçantë si prind, dua të përgëzoj djalin tim, Taulant Xhakën, për arritjen e tij

madhështore si lojtari me saktësinë më të lartë në pasime në Superligën Zvicerane. Ky është një moment që pasqyron jo vetëm talentin dhe punën e tij të palodhshme, por edhe vlerat e tij si sportist i përkushtuar dhe shembull për të gjithë. Taulanti ka treguar

vazhdimisht se është një lider në fushë, duke mbajtur lart jo vetëm emrin e tij, por edhe krenarinë e familjes sonë dhe të gjithë shqiptarëve. Kjo arritje është një frymëzim për çdo të ri që ndjek ëndrrat me përkushtim dhe pasion. Krenar me ty Taulant!”, ka shkruar Ragip Xhaka.



Nipi i Adem Jasharit, Igball Jashari përforcon Drenicën

“Epoka e re”

PRISHTINË, 8 JANAR - Nipi i Komandantit Legjenda të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Adem Jashari, Igball Jashari është përforcimi i parë i skuadrës së Drenicës. Klubi kuqezi është shprehur mjaftë i lumtur me transferimin e Jasharit, duke vlerësuar si një “armë” shtesë për sulmin e skuadrës. “Më kënaqësi dhe privilegj ju njoftojmë që Igball Jashari, është përforcimi i radhës i ekipit tonë. Sulmuesi i familjes emblematike Jashari, do të jetë ‘armë’ shtesë për

sulmin e skuadrës tonë. Jashari është një lojtar i shumë i talentuar, dhe i rrezikshëm për kundërshtarët. Ai ishte pjesë e FC Prishtina. Ai tashmë do të mbrojë ngjyrat kuq e zi, të vendlindjes se tij, dhe për klubin e tij të zezës nga ku mori hapat e parë si futbollist. Është kënaqësi e veçantë që je në mesin tonë. Mirësevjen Igball Jashari. Bashkë drejt Superligës”, thuhet në njoftimin e Drenicës. Për largimin e Drenicës. Igball Jashari ka reaguar edhe skuadra e Prishtinës. Kjo e fundit konfirmoi se largimi erdhi pas

kërkesës së Jasharit, i cili të mërkurën është prezantuar te Drenica. “Igball Jashari, me kërkesën e tij, ka gjetur gjuhën e përbashkët me klubin për të shkëputur kontratën. Jashari me FC Prishtinën ka debutuar në sezonin 2022/23 ku në atë edicion kishte katër paraqitje dhe një asistim. Ndërsa këtë edicion ka pasur 9 paraqitje duke realizuar edhe një gol. Në total në dy vite, Jashari me FC Prishtinën ka regjistruar 35 paraqitje, 3 gola dhe 1 asistim. FC Prishtina falënderon ‘Igin’ duke i dëshiruar sukses në vazhdim të karrierës”, thuhet në njoftimin e Prishtinës.



Çeku: Donjeta Sadiku dhe sportistët e tjerë po ushtrojnë në kushte më të mira

PRISHTINË, 8 JANAR (ER) - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), Hajrulla Çeku ka thënë se boksierja Donjeta Sadiku dhe shumë sportistë të tjerë po ushtrojnë në kushte më të mira, falë investimeve në infrastrukturën sportive nga qeveria Kurti. “Boksierja Donjeta Sadiku e vetme dhe pa ndihmën e shtetit ka sjellë medalje për vendin tonë,

duke u stërvitur në kushte që nuk e plotësonin asnjë standard të boksit profesional. Në mandatin tonë nuk guxonte të vazhdonte ky trajtim. Andaj falë bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Sportit me AKP-në dhe Federatën e Boksit, ajo tash ushtron në hapësirën e re stërvitore në Hotel Grand. Kjo sportiste sikurse shumë të tjerë

ushtrojnë në kushte më të mira, falë investimeve në infrastrukturën sportive nga qeveria Kurti. Në vitin 2019, buxheti për subvencionimin e sportit ishte vetëm 3 milionë. Ndërsa në 2024, 11 milionë euro. Kjo punë është bërë vetëm në një mandat. Shumë punë të tjera na presin në mandatin e ardhshëm”, ka shkruar Çeku në “Facebook”.

Kukaj ndahet me Prishtinën

PRISHTINË, 8 JANAR (ER) - FC Prishtina ka konfirmuar se ndihmëstrajneri, Liridon Kukaj, nuk do të jetë më pjesë e skuadrës bardhekaltër. Skuadra kryeqytetase bën me dije se kontrata është shkëputur me

marrëveshje ndërmjet dy palëve pas kërkesës së trajnerit Kuka. “Kukaj ka qenë pjesë e stafit teknik tash e disa kohë, duke filluar nga U19 e skuadrës deri te ekipi i parë. Kukaj është njëri ndër futbollistët me më së

shumti paraqitje si futbollist i skuadrës bardhekaltër”, thuhet në njoftimin e Prishtinës. Ndarjen me klubin kryeqytetase e ka konfirmuar edhe Kukaj me anë të një postimi në “Facebook”. “Pas një kohe i

erdhi fundi edhe bashkëpunimit me klubin e zezës. Faleminderit FC Prishtina nga presidenti e deri te më i riu që punuam bashkë. Mirupafshim dhe shumë suksese klubit”, ka shkruar Kukaj.



Verstappen, rivalëve: Mos më provokoni, mund të përfundoni keq

MILTON KEYNES, 8 JANAR - Karakteristikë e kampionëve të Formula 1 është se dinë të marrin më të mirën edhe kur garojnë nën presion. I tillë është Max Verstappen, që duket se emocionohet pikërisht kur shiriti i pritshmërive rritet në mënyrë dramatike. Këtë gjë e tregoi

edhe në vitin e kaluar, kur fitoi titullin e katërt për pilotë. Nëse në vitin 2023 gjithçka ishte "fushë me lule" për të, vitin e kaluar pati mjaft përballje në pistë, si me Lando Norris apo George Russell, duke pasur mjaft polemika e penaltete. Çka solli në mjaft përplasje gjatë dhe pas garave

e megjithatë Verstappen nuk ndryshoi asgjë në sjelljen e tij. Kur i vihet në dukje kjo kokëfortësi, Verstappen nuk humb kohë për t'u dërguar një mesazh të fortë rivalëve të tij. "Nëse më provokoni apo më stimuloni ambicien, gjërat për mua do të shkojnë më mire dhe ju do të përfundoni keq",

janë fjalët e Max Verstappen për "Blick". Holandezi përsëriti se do të mbetet i njëjti pilot, edhe nëse FIA ndryshon udhëzimet në duet: "Nuk do të ndryshoj stilin tim të drejtimit. Unë di të dalloj kur e kam ekzagjeruar. Për shembull, në Abu Dhabi godita Piastrin në fillim. Nuk e



kisha problem t'i kërkoja falje pas garës".

Deschamps konfirmon largimin nga Kombëtarja e Francës pas Kupës së Botës

PARIS, 8 JANAR - Didier Deschamps e ka konfirmuar largimin nga Kombëtarja e Francës pas Kupës së Botës 2026. Ashtu siç u zbulua më herët, selektori i "Trekolorëve" do t'i japë fund eksperiencës me këtë ekip vitin tjetër, Didier Deschamps ka konfirmuar të mërkurën se nuk do të vazhdojë të jetë selektor i Francës në futboll pas Kampionatit Botëror të vitit 2026. "Jam këtu që nga viti 2012. Është planifikuar të qëndroj deri në vitin 2026, deri në Botërorin e ardhshëm dhe atje do të përfundojë pasi duhet të ketë një fund", deklaroi ish-futbollisti i njohur francez në intervistë me mediumin francez "TF1". 56-vjeçari ishte shpallur kampion i botës me Francën në vitin 2018, ndërsa ishte kampion bote edhe si futbollist në shekullin e kaluar. Me Deschamps, i cili e kishte marrë postin e Laurent Blancut, Franca kishte shkuar edhe në finale të Botërorit 2022 e të Evropianit 2016. "Gjëja më e rëndësishme është që ekipi i Francës të mbetet në majë, aty ku ishte për shumë e shumë vjet, nuk jam këtu për rekorde",



vazhdoi ish-trajneri i Monacos, Juventusit e Marseillet, i cili sipas të gjitha gjasave do të pasohet nga Zinedine Zidane. Natyrisht, Deschamps synon të largohet nga Kombëtarja si kampion bote, ndërsa nuk ka zbuluar se si të do të jetë jeta e tij pa Kupën së Botës 2026.

Zidane, favorit absolut për trajner të Francës

Zinedine Zidane lidhet me një rikthim në futboll afro katër vjet pas ndeshjes së tij të fundit.

"Zizou" e mbylli eksperiencën e dytë me Real Madridin në vitin 2021 pasi dështoi të fitonte trofe në sezonin e fundit në "Santiago Bernabeu". Mesfushori legjendar e kishte fituar tri herë radhazi titullin e Ligës së Kampionëve me Realin në eksperiencën e tij të parë, ndërsa e kishte ngritur lart edhe trofeun e La Ligas, në vitet 2017 e 2020. "Le Parisien" raporton se ish-futbollisti i Juventusit e Real Madridit është favorit për ta marrë pozitën e Didier Deschamps si trajner i Kombëtares së Francës.

Bostoni triumfon në fushën e Denverit

DENVER, 8 JANAR - Kampionët e Boston Celtics arritën një fitore të rëndësishme në fushën e Denverit me shifrat 118-106.



Tatum me 29 pikë dhe Porzingis me 25 pikë bënë diferencën në fushë për miqtë. Tjetër humbje për ekipin e

Lakersave, që u mund me shifrat 118-97 nga Dallasi. Vendimtar stoli i ekipit teksan, nga ku erdhën 50 pikë, ndërkohë që shënuesi më i mirë ishte Grimes me 23 pikë. Zhgënjën edhe skuadra e Golden State, që u mund me shifrat 114-98 nga Miami, ndeshje ku u dallua kolektiviteti i ekipit nga Florida, me gjashtë lojtarë që realizuan mbi 10 pikë. 31 pikët e Curry mbetën për statistikë.

REZULTAT

Washington - Houston	112-135
Charlotte - Phoenix	115-104
Dallas - Lakers	118-97
New Orleans - Minnesota	97-104
Utah Jazz - Atlanta	121-124
Golden State - Miami	98-114
Denver - Boston	106-118

SHKURT

Drejtori i Lecces për të ardhmen e Ramadanit: Është një lojtar titullar

Drejtori sportiv i Lecces, Pantaleo Corvino, ka folur për merkaton e skuadrës pulieze. I pyetur në lidhje me të ardhmen e mesfushorit shqiptar, Ylber Ramadani, ai ka deklaruar se 28-vjeçari është pjesë e rëndësishme e skuadrës. "Ramadani është një lojtar titullar. E ka treguar në fushë këtë", ka thënë Corvino. Gjithsesi e ardhmja e mesfushorit shqiptar duket e paqartë, pasi nuk ka luajtur në ndeshjet e fundit në kampionat. Zërat e merkatos e afrojnë Ramadanin me Napolin, por deri tani nuk ka asgjë konkrete në këtë drejtim.

Atalanta interesohet për Brojën

Atalanta synon që të përforcojë repartin e sulmit gjatë merkatos së janarit. Drejtuesit e klubit zikaltër po studiojnë disa alternativa dhe janë fokusuar tek 3 lojtarë të Evertonit në repartin e avancuar, mes të cilëve edhe Armando Broja. Sulmuesi përfaqëson një emër tashmë të njohur në Zingonia: shqiptari, i cili po rikuperohet nga një dëmtim, ishte në vëmendjen e Atalantës kur luante për Chelsean. Profili i tij mbetet interesant për të kompletuar repartin ofensivë. Nëse tratativat do të përfundonin me sukses, atëherë Broja do të bëhej shok skuadre me kapitenin e kombëtares, mbrojtësin Berat Gjimeshi, që është një pikë referimi në mbrojtjen e Atalantës.

Arsenali me ofertë zyrtare për Nico Williams

Skuadra e Arsenalit po sfidon Chelsean dhe Liverpoolin për shërbimet e sulmuesit të krahut, spanjollin Nico Williams. Raportohet se Arsenali tashmë i ka bërë ofertë zyrtare Athletic Bilbaos për Williamsin, të cilin trajneri Mikel Arteta po e kërkon me çdo kusht. Për transferimin e Williamsit gjatë këtij muaji, thuhet se Arsenali ka ofruar hiq më pak se 60 milionë euro kurse 22-vjeçarit i ka ofruar kontratë pesëvjeçare. Williams ka kontratë me Bilbaon deri në vitin 2027, ndërsa këtë sezon ka shënuar 2 gola dhe ka bërë 5 asistime në 24 ndeshje të luajtura në të gjitha garat.

Liverpooli, gati 50 milionë euro për Tchouamenin

Liverpooli edhe pse po zhvillon një sezon perfekt, sërish kërkon të ndërhyjë në merkato. Të kuqtë janë gati që të bëjnë një sforco ekonomike për të nënshkruar me Aurelien Tchouameni, mesfushorin e Real Madridit. Që kur u bë pjesë e "Los Blancos", francezi u dallua me paraqitjet e tij, por në këtë sezon, ai është aktivizuar në mënyrë të limituar për shkak të konkurrencës. Trajneri Carlo Ancelotti e ka mbështetur lojtarin, ndërsa e ka aktivizuar edhe në qendër të mbrojtjes. Sipas "Fichajes.net", Liverpooli ofron 50 milionë euro për kartonin e 24-vjeçarit, por në garë është dhe Manchester City që kërkon një mesfushor në janar.

Neymari synon të luajë në Kupën e Botës 2026

Neymar Junior ka shprehur dëshirën e tij të fortë për të luajtur në Kupën e Botës 2026, duke pranuar se kjo mund të jetë mundësia e tij e fundit për të marrë pjesë në turneun prestigjioz. Sulmuesi brazilian synon

të luajë edhe një Kampionat Botëror me kombëtaren e tij, duke qenë pjesë e ngjarjes së vitit 2026, e cila pritet të mbahet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Meksikë dhe Kanada. "Unë

vërtet besoj në ekip, në lojtarët e rinj që vijnë. Sot nuk jemi në pozicionin që do të donim të ishim, por së bashku mund të arrijmë diçka të madhe. Kemi një vit, një vit e gjysmë për të punuar. Do të bëj gjithçka

siç duhet dhe të arrijmë në Kupën e Botës", ka thënë Neymar. Kur u pyet nëse ai mendon se ka mundësi të kthehet në kombëtare për vitin 2026, Neymar u përgjigj pozitivisht. "Do të përpiqem. Dua të jem atje.

Do të bëj gjithçka që mundem për të qenë pjesë e ekipit. E di që ky mund të jetë Botërori im i fundit, shansi im i fundit dhe do të bëj gjithçka për të luajtur në të", ka përfunduar 32-vjeçari.



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVA

INSTITUTI PEDAGOGJIK I KOSOVËS
PEDAGOSKI INSTITUT KOSOVA
KOSOVO PEDAGOGICAL INSTITUTE

Prishtinë, 08.01.2025

Në bazë të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtarinë Kërkimor-shkencor (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/02 maj 2013), neni 48 të Statutit të Institutit Pedagogjik të Kosovës në Prishtinë, Rregullores nr. 55/24 të datës 12.09.2024 për Procedurat e Zgjedhjes dhe Rizgjedhjes së Punëtorëve Shkencor dhe Hulumtuesve në Institutin Pedagogjik të Kosovës, Ligjit të Punës nr. 03/L212, vendimit nr. 111/24 të datës 26.12.2024, Këshilli Shkencor i Institutit, shpallë:

KONKURS ZGJEDHJE, RIZGJEDHJE - AVANCIM TË PUNONJËSVE SHKENCORË DHE TË HULUMTUESVE

2 (Dy) hulumtues të pavarur, prej të cilëve:

- 1.1. 1 (Një) hulumtues i pavarur për mësimdhënie dhe zhvillim profesional të mësimdhënësve;
- 1.2. 1 (Një) hulumtues i pavarur për edukim parashkollor dhe parafilior.

Përshkrimi i punëve për pozitën 1.1.

- Bën hulumtime analiza dhe projekte në fushën e mësimdhënies dhe zhvillimit profesional të mësimdhënësve;
- Analizon programet përgatitore për mësimdhënës dhe programet e zhvillimit të vazhdueshëm profesional të mësimdhënësve;
- Propozon dhe përgatit tema dhe projekte të caktuara që lidhen me fushën e mësimdhënies dhe zhvillimit profesional të mësimdhënësve gjatë karrierës;
- Bën analiza, vlerësime dhe hulumtime profesionale që lidhen me fushën e mësimdhënies dhe zhvillimit profesional të mësimdhënësve, individualisht dhe në bashkëpunim me punonjësit shkencor dhe profesional të Institutit;
- Organizon dhe koordinon trajnime profesionale në fushën përkatëse si dhe ndërmjetëson organizimin e trajnimeve;
- Ndihmon punonjësit shkencor dhe profesional të Institutit, në përgatitjen e botimeve të ndryshme dhe në nxjerrjen e revistës së IPK-së;
- Organizon punëtori në fushën e mësimdhënies dhe zhvillimit profesional të mësimdhënësve gjatë karrierës;
- Harton planin individual të punës kërkimore-shkencore dhe profesionale;
- Përgatit raportin për punët e realizuara
- Kryen punë të tjera që i delegon udhëheqësi i departamentit dhe Drejtori.

Përshkrimi i punëve për pozitën 1.2.

- Bën hulumtime analiza dhe projekte në fushën e edukimit parashkollor dhe parafilior;
- Analizon programet përgatitore për edukatorët dhe personelin profesional për edukim parashkollor dhe parafilior;
- Propozon dhe përgatit tema dhe projekte të caktuara që lidhen me fushën e edukimit parashkollor dhe parafilior;
- Bën analiza, vlerësime dhe hulumtime profesionale që lidhen me fushën e edukimit parashkollor dhe parafilior, individualisht dhe në bashkëpunim me punonjësit shkencor dhe profesional të Institutit;
- Organizon dhe koordinon trajnime profesionale në fushën përkatëse si dhe ndërmjetëson organizimin e trajnimeve;
- Ndihmon punonjësit shkencor dhe profesional të Institutit, në përgatitjen e botimeve të ndryshme dhe në nxjerrjen e revistës së IPK-së;
- Organizon punëtori në fushën e edukimit parashkollor dhe parafilior;
- Harton planin individual të punës kërkimore-shkencore dhe profesionale;
- Përgatit raportin për punët e realizuara
- Kryen punë të tjera që i delegon udhëheqësi i departamentit dhe Drejtori

Kandidati për hulumtues të pavarur duhet t'i plotësojë këto kushte:

- Të jetë i/e regjistruar në studimet e doktoratës në programe relevante me pozitën e shpallur dhe fushëveprimtarinë e Institutit Pedagogjik të Kosovës;
- Të ketë punime të publikuara në revista shkencore të indeksuara. Punimet e publikuara në revista shkencore të indeksuara duhet të jenë të njohura sipas rregulloreve në fuqi.
- Të ketë punime të publikuara në revistën "Kërkime Pedagogjike".
- Të ketë marrë pjesë në aktivitete shkencore, brenda dhe jashtë vendit, nga fusha përkatëse.
- Të ketë marrë pjesë në mënyrë aktive në konferencat kombëtare dhe ndërkombëtare, nga fusha përkatëse;
- Të ketë përvojë të dëshmuar për aktivitete shkencore e profesionale nga fusha e kërkuar me konkurs.

Dokumentacioni i nevojshëm

Kandidati/ja duhet të dorëzojë dokumentacionin si vijon:

- Dëshmi për regjistrimin e studimeve të (doktoratës);
- Certifikatën e lindjes jo më të vjetër se gjashtë muaj;
- Dëshmi të lëshuar nga Gjykata kompetente, përmes së cilës dëshmohet që kandidati nuk është i dënuar;
- CV-në e përditësuar, së cilës duhet t'i bashkëngjiten dëshmitë e nevojshme për të vërtetuar gjendjen e paraqitur në të;
- Listën e botimeve në revista ndërkombëtare të njohura sipas rregulloreve në fuqi duke evidentuar: autori/ët, titulli i punimit, revista, numri dhe/apo vëllimi i botimit si dhe linku i indeksimit me numër DOI (me kopjen e botimeve të paraqitura).
- Listën e botimeve në revista tjera, vendore e ndërkombëtare duke evidentuar: autori/ët, titulli i botimit, lloji i botimit, botuesi dhe vegëza e botimit me <https://www...> (me kopjen e botimeve të paraqitura).
- Dëshmi tjera për të arriturat shkencore si: artikuj, libra, monografi, konferenca shkencore, etj. (me kopjen e botimeve të paraqitura).
- Të gjitha dëshmitë duhet të përgatiten sipas shtojcës I dhe II e cila gjendet në Rregulloren për Zgjedhjen dhe Rizgjedhjen e punëtorëve Shkencor dhe Hulumtuesve të Institutit.
- Kandidatët me rastin e aplikimit dokumentacionit i bashkëngjisin kopjet e dokumenteve mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkon vendi i punës për të cilin konkurrojnë.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit të tij në faqen zyrtare të Institutit në internet.

Zgjedhja e personelit shkencor të Institutit Pedagogjik bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtarinë Kërkimore - shkencore, të Statutit të Institutit Pedagogjik dhe të Rregullores për Procedurat e Zgjedhjes dhe Rizgjedhjes së Punëtorëve Shkencor dhe Hulumtuesve.

Pozitat 1.1 dhe 1.2 janë me mandat 3 vjeçar me mundësi ri-zgjedhje, zgjedhje apo avancim.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor nga Instituti, dhe janë të obliguar të sjellin me vete dokumentet origjinale mbi kualifikimet dhe trajnimet e kryera për verifikim para Komisionit.

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në këtë nr. tel: 038/20020169, prej orës 08:00 - 16:00.

Dokumentacioni i kompletuar dorëzohet në adresën: Instituti Pedagogjik i Kosovës në Prishtinë, (Pejton, rruga "Lorenç Antoni", nr. 38).

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Florentin Ramushi shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Vebi Ibrahim" Uglar Komuna Gjilan, nga Kl. I-IX.

Jetlir Rrustemaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës së mesme "Kadri Kusari".

Lumnije Cocaj shpall te pavlefshme dokumentet dublikatë sh.m.e. "Ymer Prizreni" Prizren.

Arjete Bytyqi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII sh.f.m.u. "Sinan Thaqi" Zojz.

Shani Rexhepi shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën Q.K. "11 Marsi" Prizren.

Bekri Gashi shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën Q.K. "11 Marsi" Prizren.

Vjosa Kopllon Hoti nga Rahoveci shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "12 Maji".

Xhemali Krasniqi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës fillore "Haxhi Hoti".

Kreshnik Alijaj B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 810246745.

Viza Group SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811126376.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVA



INSTITUTI PEDAGOGJIK I KOSOVËS
PEDAGOSKI INSTITUT KOSOVA
KOSOVO PEDAGOGICAL INSTITUTE

Priština, 08.01.2025.

Na osnovu Zakona br. 04/L-135 o naučno-istraživačkoj delatnosti (Službeni list Republike Kosovo, br. 11/od 2. maja 2013), člana 48. Statuta Pedagoškog instituta Kosova u Prištini, Uredbe br. 55/24 od 12.09.2024. godine, o procedurama izbora i reizbora naučnih radnika i istraživača u Pedagoškom institutu Kosova, Zakona o radu br. 03/L212, Odluke br. 111/24 od 26.12.2024. godine, Naučni odbor Instituta, raspisuje:

KONKURS

Za IZBOR, REIZBOR – NAPREDOVANJE NAUČNIH RADNIKA I ISTRAŽIVAČA

2 (Dva) samostalna istraživača, od kojih:

- 1.3. 1 (Jedan) samostalni istraživač za nastavu i stručno usavršavanje nastavnika;
- 1.4. 1 (Jedan) samostalni istraživač za predškolsko i predosnovno obrazovanje.

Opis poslova za radno mesto 1.1.

- Sprovodi istraživanja, analize i projekte u oblasti nastave i stručnog usavršavanja nastavnika;
- Analizira pripreme programe za nastavnike i programe kontinuiranog stručnog usavršavanja nastavnika;
- Predlaže i priprema određene teme i projekte koji se odnose na oblast nastave i stručnog usavršavanja nastavnika tokom karijere;
- Sprovodi analize, evaluacije i stručna istraživanja koje se odnose na oblast nastave i stručnog usavršavanja nastavnika, individualno i u saradnji sa naučnim i stručnim radnicima Instituta;
- Organizuje i koordinira stručne obuke iz relevantne oblasti kao i posreduje u organizaciji obuka;
- Pomaže naučnim i stručnim radnicima Instituta u pripremi različitih publikacija i izdavanju časopisa PIK-a;
- Organizuje radionice iz oblasti nastave i stručnog usavršavanja nastavnika tokom karijere;
- Izrađuje individualni plan naučno-istraživačkog i stručnog rada;
- Priprema izveštaj o obavljenim radovima;
- Obavlja i druge poslove koje mu delegira rukovodilac odeljenja i direktor.

Opis poslova za radno mesto 1.2.

- Sprovodi istraživanja, analize i projekte iz oblasti predškolskog i predosnovnog obrazovanja;
- Analizira pripreme programe za vaspitače i stručno osoblje za predškolsko i predosnovno obrazovanje;
- Predlaže i priprema određene teme i projekte iz oblasti predškolskog i predosnovnog obrazovanja;
- Sprovodi analize, evaluacije i stručna istraživanja koje se odnose na oblast predškolskog i predosnovnog obrazovanja, individualno i u saradnji sa naučnim i stručnim radnicima Instituta;
- Organizuje i koordinira stručne obuke iz relevantne oblasti kao i posreduje u organizaciji obuka;
- Pomaže naučnim i stručnim radnicima Instituta u pripremi različitih publikacija i izdavanju časopisa PIK-a;
- Organizuje radionice iz oblasti predškolskog i predosnovnog obrazovanja;
- Izrađuje individualni plan naučno-istraživačkog i stručnog rada;
- Priprema izveštaj o obavljenim radovima;
- Obavlja i druge poslove koje mu delegira rukovodilac odeljenja i direktor.

Kandidat za samostalnog istraživača treba da ispunjava ove uslove:

- Da je upisan/a na doktorske studije na relevantnim programima sa objavljenim radnim mestom i delokrugom Pedagoškog instituta Kosova;
- Da ima objavljene radove u indeksiranim naučnim časopisima. Objavljeni radovi u indeksiranim naučnim časopisima treba da budu priznati u skladu sa važećim uredbama.
- Da ima objavljene radove u časopisu „Pedagoška istraživanja“.
- Da je učestvovao u naučnim aktivnostima, u zemlji i inostranstvu, iz relevantne oblasti;
- Da je aktivno učestvovao na domaćim i međunarodnim konferencijama, iz relevantne oblasti;
- Da ima dokazano iskustvo u naučnim i stručnim aktivnostima iz oblasti tražene konkursom;

Potrebna dokumentacija

Kandidat/kinja treba da dostavi sledeću dokumentaciju:

- Dokaz o upisu studija (doktorata);
- Izvod iz matične knjige rođenih, ne stariji od šest meseci;
- Dokaz izdat od strane nadležnog suda, kojim se dokaže da kandidat nije osuđivan;
- Ažurirani CV, kojem treba priložiti potrebne dokaze za dokazivanje stanja koja je u njemu prikazana;
- Spisak publikacija u priznatim međunarodnim časopisima u skladu sa važećim uredbama, sa isticanjem: autora, naslova rada, časopisa, broja i/ili izdanja publikacije kao i linka za indeksiranje sa DOI brojem (sa kopijom prezentovanih publikacija).
- Spisak publikacija u drugim, domaćim i međunarodnim časopisima, isticanjem: autora, naslova rada, vrste publikacije, izdavača i linka publikacije sa <https://www...> (sa kopijom prezentovanih publikacija).
- Ostali dokazi o naučnim dostignućima kao što su: članci, knjige, monografije, naučne konferencije itd. (sa kopijom prezentovanih publikacija),
- Svi dokazi treba da budu pripremljeni u skladu sa Prilogom I i II koji se nalaze u Uredbi o izboru i reizboru naučnih radnika i istraživača Instituta.
- Prilikom podnošenja prijave, uz dokumentaciju kandidati prilažu kopije dokumenata o stručnoj spremi, iskustvu i drugu potrebnu dokumentaciju koju zahteva radno mesto za koje konkurišu.

Konkurs ostaje otvoren 15 dana od dana njegovog objavljivanja na zvaničnoj internet stranici Instituta.

Izbor naučnog osoblja Pedagoškog instituta vrši se u skladu sa odredbama Zakona br. 04/L-135 o naučno-istraživačkoj delatnosti, Statuta Pedagoškog instituta i Uredbe o procedurama izbora i reizbora naučnih radnika i istraživača.

Radna mesta 1.1 i 1.2 su na mandat od 3 godine uz mogućnost reizbora, izbora ili napredovanja.

Izabrane kandidate na uži spisak, Institut će pismeno ili telefonom obavestiti u zakonskom roku, i dužni su da sa sobom ponesu originalna dokumenta o stručnoj spremi i pohađanim obukama, radi provere pred Komisijom.

Za dodatne informacije možete kontaktirati ovaj broj telefona: 038/20020169, od 08:00 - 16:00 časova.

Kompletna dokumentacija sa dostavlja na adresu: Pedagoški institut Kosova u Prištini, (Pejton, ulica „Lorenc Antoni“, br. 38).

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES DHE TEKNOLOGJISË
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr. 7 / 1-2025
Dt. 09.01.2025

KONKURS

PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE PËR VITIN SHKOLLOR 2024/2025, KLASËT E 10-ta PËR VIJUES NË ARSIMIN E MESËM TË LARTË PROFESIONAL – MESIMI PËR TË RRITUR

Për plotësimin e vendeve të lira për regjistrimin e nxënësve në klasën e dhjetë (10) në

Qendren e Kompetencës në Prizren, **shpallim këto drejtime:**

	I. Ekonomi		
1	Nepunes Industrie	1 Paralele	24 nxënës
	II. Tregti		
1	Sherbimet ndaj konsumatorit	1 Paralele	24 nxënës
	III. Turizem		
1	Asistent ne organizimin e eventeve	1 Paralele	24 nxënës

1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, për vijimin e mësimin për të rritur në shkolla profesionale, për vitin shkollor 2024/2025, mund të konkurrojnë kandidatët të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe që janë më të vjetër se 19 vjeç.

Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9-të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASHT dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të shkollave profesionale, duhet të paraqesin këto dokumente:

Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron)

Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe Certifikatën e lindjes.

1. Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve bëhet 10 ditë nga dita e shpalljes. Dorëzimi i dokumenteve bëhet në lokalet e shkollës në Qendrën e Kompetencës në Prizren, nga ora 10:00-14:00.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Dvorani Home” Sh.P.K. me seli në Malishevë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. UNIK: 812025684 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Dvorani Home” D.O.O. od Malishevo, donelo odluku o prestani rada sa nr. 812025684 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “Dvorani Home” L.L.C. with headquarters Malisheva, has come to the decision to quit its business: 812025684 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales





MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

